

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Arrestohet në Rusi Shpëtim Aliu, një nga “bossët” e rrjetit të trafikut ndërkombëtar të kokainës
ADRESA	https://boldnews.al/2026/09/23/arrestohet-ne-rusi-shpetim-alu-nje-nga0/
BURIMI	boldnews.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	23 shtator 2026, 18:51:13 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 300 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	23 shtator 2026, 18:32:30 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	8b944c214f0485fb0761aa1ca96aacd974be9a355788bc0a82147d0ea1f61ce5
TEKSTI	8a385635e94368284019547f296ded3e31ebf75c54eda669c6cbefc1842c5b64
PAMJA	82e2b7f4a5a3b3aec15db741104ab34e88958f227e976b23536245a94dd57796

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	e6e527750fddd8ef37fd95fdd0dd0a6a2b22780ddea33535863f39de2a793197
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0a84bfe3f4510e3e6e98dba2fbf96359a912d940176f0d9eba05fd7152dcd223
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/e6e527750fddd8ef37fd95fdd0dd0a6a2b22780ddea33535863f39de2a793197>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

Fillimi > AKTUALITET

Arrestohet në Rusi Shpëtim Aliu, një nga “bossët” e rrjetit të trafikut ndërkombëtar të kokainës

20:32 : 23/09/2026 në AKTUALITET, KRONIKE, KRYESORE



Salvatore alias Shpëtim Aliu, i shpallur në kërkim nga drejtësia shqiptare dhe i konsideruar nga Prokuroria e Posaçme si një prej figurave kyçe të trafikut të kokainës, është arrestuar ditën e sotme në Rusi.

SPAK i ka caktuar 51-vjeçarit masën e sigurisë “Arrest në burg”, për veprat penale “Trafikimi i narkotikëve”, “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, “Grupi i strukturuar kriminal” dhe “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”.

“Si rezultat i bashkëpunimit informativ dhe operacional ndërmjet specialistëve të Drejtorisë së Interpolit dhe homologëve të Interpol Moskës, u arrestua provizorisht, me qëllim ekstradimin në Shqipëri:

-S. A., 51 vjeç, i kapur në Rusi, të cilit, në muajin qershor, 2026, Gjykata e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimitit të Organizuar i ka caktuar masën e sigurisë “Arrest në burg”, për veprat penale “Trafikimi i narkotikëve”, “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, “Grupi i strukturuar kriminal” dhe “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”. - thuhet në njoftimin e policisë.

Në bashkëpunim me homologët në Moskë, Interpol Tirana vijon procedurat për ekstradimin e tij në Shqipëri.

Lexo edhe:

Shisnin drogë pranë shkollave, arrestohen 2 persona në Berat, sekuestrohen mbi 4 kg kanabis

Shiste kanabis me përqindje të lartë THC-je, arrestohet 26-vjeçari në Mamurras /EMRI

Kush është Salvatore alias Shpëtim Aliu?

Salvatore Aliu, i konsideruar si kumbari i grupeve shqiptare të narkotrafikut, dyshohet të ketë pastruar në Shqipëri të paktën 30 milionë euro të siguruara nga aktivitetet kriminale.

Figura kyçe, duket se ka qënë i vëllai i Jos Aliu, i cili ka qënë njëri prej 4 kompani të ndërkombëtarë të

TË GJITHA



9 faqet e SHISH në makinën e Agasit, bashkëpunim apo nxjerrje informacioni? Ku nis përgjegjësia penale?

20:42 : 23/09/2026



Arrestohet në Rusi Shpëtim Aliu, një nga “bossët” e rrjetit të trafikut ndërkombëtar të kokainës

20:32 : 23/09/2026



Administrata Trump po përgatit planin për ndalimin 90-ditor të eksporteve të naftës

20:17 : 23/09/2026



Stresi dhe inflamacioni mund të dëmtojnë zemrën në heshtje

20:17 : 23/09/2026



Berisha përjashton bojkotin e Parlamentit: Do ishte në favor të Ramës

20:04 : 23/09/2026



Dosja e SHISH, Salianji: Shteti ka rënë në duart e bandave

19:55 : 23/09/2026



Haxhiu i ftoi në takim, familjarët e 4 ish-krerëve të UÇK-së refuzojnë: Pasi Kuvendi të marrë vendim për Hagën

19:47 : 23/09/2026

Figura kryesore, detyrues dhe venditor, Isak Aliu, i cili ka zbuluar kompanitë më të mëdha të përdorura për investime në blerje pasurish të paluajtshme, vila, apartamente, troje, apo dhe në ndërtim, edhe hotelesh në zona turistike të vendit.

Salvatore përdorte platformën SKY për komunikimet e tij, ku ai njihej me emra të ndryshëm si Dala, Qero, Qerosi, Viktor, apo Albo Pelon.

Nga zbardhja e këtyre komunikimeve, në një bisedë në gusht të vitit 2020, me vëllain Isa Aliu, ky i fundit e njofton se kishte në gjendje 6 milion euro. Dy javë më pas, Salvatore njofton Isain se do të marrë edhe 20 milionë euro të tjera. Në pritje që paratë të investohen për t'u pastruar, ai e udhëzon vëllanë, se si t'i fshehë paratë, duke i sugjeruar, ndër të tjera dhe futjen e tyre në fuçi 50 litërshe e më pas groposjen.

Hetimi që çoi në zbulimin dhe identifikimin e Salvatore Aliut, ka nisur në maj të vitit 2020, pas një referimi nga policia. Ai, dhe persona me lidhje familjare dyshohet të jenë përfshirë në trafikun ndërkombëtar të kokainës nga Ekuadori, drejt vendeve europiane. Në rrjetin ku bënë pjesë dhe të huaj, Salvatore është identifikuar të ketë patur rolin e drejtuesit, duke mbikëqyrur çdo hallkë të trafikut që nga sigurimi i kokainës, te financimi i ngarkesave dhe furnizimi i grupeve të tjera.

Hetimet e SPAK

Në muajin qershor, 2026, Gjykata e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimin të Organizuar i ka caktuar masën e sigurisë “Arrest në burg”, për veprat penale “Trafikimi i narkotikëve”, “Pastrimi i produkteve të veprës penale ose veprimtarisë kriminale”, “Grupi i strukturuar kriminal” dhe “Kryerja e veprave penale nga organizata kriminale dhe grupi i strukturuar kriminal”.

Sipas hetimeve nga SPAK, gjatë viteve 2019-2021, grupi kriminal i Salvador Aliut ka operuar në Amerikën Latine, Brazil, Belgjikë dhe Holandë.

Aliu ishte personi që ka luajtur një rol universal në gjithë skemën e trafikimit të lëndës narkotike, duke shërbyer si hallka furnitore. Ai ishte figura qendrore që furnizonte me kokainë grupet e Shpëtim Gjithë, Eldi Dizdarit dhe Armando Pacanit.

Në njoftimin zyrtar SPAK, thekson se në zbatim të vendimeve gjyqësore janë zhvilluar 23 kontrole ndaj personave, banesave, zyrave të shoqërive tregtare dhe personave fizikë.

Gjatë hetime janë mbledhur provat e nevojshme, prej të cilave janë provuar 5 episode të trafikimit të kokainës në sasi të mëdha. Gjatë tyre janë sekuestruar në total 8 ton e 960 kg lëndë narkotike e llojit kokainë dhe konkretisht:

Episodi 1 – 11 Maj 2020 – Trafikimi i një sasi prej 700 kilogramë lëndë narkotike të llojit kokainë, e sekuestruar në portin e Waasland (Antverp), Belgjikë, e gjetur në një kontejner me pjesë këmbimi makinash, i shkarkuar nga një anije e ardhur nga Kina.

Episodi 2 – 6 Qershor 2020 – Tentativa e trafikimit të një sasi prej 2010 kilogramë lëndë narkotike e llojit kokainë, e sekuestruar në Guayaquil, Ekuador. Lënda narkotike kishte si destinacion përfundimtar të saj Holandën dhe kishte të stampuar tre logo të ndryshme (Jaguar, Shqiponjë dhe BB).


Episodi 3 – 16 Gusht.2020 – Trafikimi i një sasi prej 1100 kilogramë lëndë narkotike e llojit kokainë, e sekuestruar në Rotterdam të Holandës. Kjo ngarkesë kishte mbërritur në portin e Rotterdamt me një anije detare nga Porti i Guayaquil, Ekuador.

Episodi 4 – 16 Dhjetor 2020– Trafikimi i një sasi prej 4.1 ton lëndë narkotike kokainë, e sekuestruar në portin e Rotterdam, Holandë. Kjo ngarkesë kishte mbërritur në portin e Rotterdamt me një anije detare nga Porti i Guayaquil, Ekuador.

Episodi 5 – 03 shkurt 2021– Tentativa e trafikimit të një sasi prej 1 ton e 50 kg lëndë narkotike kokainë, e sekuestruar në Kolumbi me destinacion final Francën .

Hetimet kanë treguar se përveç episodeve të mësipërme, anëtarët e grupit kriminal kanë trafikuar nga Amerika Latine në drejtim të vendeve të Europës dhjetëra tonelata të tjera kokainë, e cila është trafikuar dhe tregtuar te persona të tjerë.

Etiketa: arrestim droge Shpëtim Aliu



Shisnin drogë pranë shkollave, arrestohen 2 persona në Berat, sekuestrohen mbi 4 kg kanabis

11:17 : 23/09/2026



Shiste kanabis me përqindje të lartë THC-je, arrestohet 26-vjeçari në Mamurras /EMRI

09:47 : 23/09/2026



Po transportonin 6 emigrantë drejt kufirit me Greqinë, arrestohen 2 persona në Vlorë

08:42 : 23/09/2026



Kosova nuk ka linja fluturimi me Azerbajxhanin! Misteri i udhëtimit të Vlora Hysenit

22:42 : 22/09/2026



Arrestohet në Morinë Vlora Hyseni

19:59 : 22/09/2026



Britani/ Nga ëndrra për futboll te burgu, shqiptari dënohet pasi u kap me drogë

20:21 : 21/09/2026



RETH NESH

Boldnews.al mbetet zgjedhja e parë për një lexues i cili kërkon të informohet me saktësi për një lajm. Misioni jonë kryesor është paanshëmëria dhe profesionalizmi dhe për këtë janë të punësuar gazetarët më të mirë në tregun mediatik.

Na kontakto:

NA NDIQ

